



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Nr: 03-111/01-9674

Datë: 24.02/2026



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE-
QENDRA KRYESORE E MJEKSISË FAMILJARE**

Bazuar ne nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarë Publik nr. 08/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-121, Rregullore (QRK) Nr.30/2024 për Procedurën e Pranimi të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

K O N K U R S
Për plotësimin e vendeve të punës

Një (1) Mjek/e Përgjithshëm në QMF-Magure

Detyrat e Punës për Mjekun e Përgjithshëm

1. Shërbimet mjekësore bazë

- Kryen vizitat mjekësore për pacientët dhe ofron trajtimin e nevojshëm sipas diagnozës.
- Vlerëson gjendjen shëndetësore të pacientëve dhe përcakton planin e trajtimit.
- Përshkruan terapi medikamentoze dhe monitoron efektet e saj.

2. Diagnostikimi dhe trajtimi

- Realizon ekzaminimet klinike dhe interpretimin e analizave laboratorike e radiologjike.
- Vendos diagnozën fillestare dhe trajton sëmundjet e zakonshme sipas kompetencës së mjekut të përgjithshëm.
- Referon pacientët për ekzaminime ose trajtim tek specialistët, kur është e nevojshme.

3. Menaxhimi i urgjencave mjekësore

- Jep ndihmën e parë mjekësore në rastet emergjente.
- Stabilizon pacientin dhe organizon dërgimin për trajtim të mëtejshëm në nivel sekondar/terciar.

4. Parandalimi dhe promovimi i shëndetit

- Kryen kontrolle preventive për sëmundjet kronike (diabeti, hipertensioni, etj.).
- Informon dhe këshillon pacientët për stil të shëndetshëm jetese dhe parandalim të sëmundjeve.
- Merr pjesë në fushata sensibilizuese dhe programe kombëtare të vaksinimit dhe parandalimit.

5. Administrimi dhe dokumentacioni

- Plotëson dhe mirëmban dokumentacionin mjekësor dhe kartelat e pacientëve sipas standardeve ligjore.
- Raporton të dhënat në sistemet elektronike shëndetësore (SISH).
- Respekton rregullat për ruajtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin e pacientit.

6. Bashkëpunimi ndërprofesional

- Punon në ekip me infermierë, teknikë, mjekë specialistë dhe stafin tjetër shëndetësor.
- Merr pjesë në konsultime mjekësore për rastet e ndërlikuara.
- Jep udhëzime dhe mbështetje për personelin ndihmës dhe infermierët.

7. Përgjegjësitë profesionale dhe ligjore

- Respekton Kodin Etik të profesionit mjekësor dhe legjislacionin në fuqi.
- Mban përgjegjësi për vendimet klinike të marra dhe për shërbimet e ofruara.
- Zbaton rregullat e sigurisë në punë dhe standardet për kontrollin e infeksioneve.

8. Detyra shtesë dhe përgjegjësia

- - Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së Shefit/es së Mjekve në QKMF
- Për punën e saj/tij i përgjigjet drejtpërdrejt Shefit/es së QKMF-së, ndërsa në mungesë të saj, Drejtorit të QKMF-së.

Kushtet dhe kriteret për Mjek të Përgjithshëm:

- Fakulteti i Mjekësisë – Drejtimi i Përgjithshëm.
- Licenca e Punës (me afat)
- Certifikata Shëndetësore (jo ma e vjetër se gjashtë muaj)
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan (jo ma e vjetër se gjashtë muaj)
- Letërnjoftimi kopje. (me afat)

Aftësitë:

- Të ketë aftësi komunikimi
- Të ketë zotësi të plotë veprimit, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur duke respektuar Ligjin si dhe etikën
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkruara më lartë
- Të ketë shkathtësi dhe kualitete personale.
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vërtetimi nga punëdhësi).

Paga mujore për Mjek të Përgjithshëm:

Grupi H klasa H10 Koeficienti: 8.4
Kohëzgjatja e kontratës me kohë të pacaktuar
Puna Provuase gjashtë muaj (6)

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike, e drejta për aplikim nga data **24.02/2026** deri **25.03/2026** me që konsiderohet si dita e fundit e konkurrimit.

Paraqitja e Aplikacioneve:

Aplikacionet mundë të merren në mënyrë fizike në zyrën për shërbime me qytetarët në Komunën e Lipjanit sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën sportel bashkë me dokumentet e kërkuar në konkurs.

Kandidatet të cilet kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës duhet që diploma e tyre të jetë e njohur (nostifikuar) nga Ministria e Arsimit Shkences dhe Teknologjisë.

Vërejtje:

Dokumentet e dorëzuara duhen të janë kopje të noterizuara (Diploma dhe Licenca) dhe ato nuk kthehen, ndërsa aplikacionet e pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen, **te gjitha njoftimet dhe rezultatet shpallen në ueb fagen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/lipjan> dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.**

